

Vendim nr. 113 datë 24.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 24.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (M) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **MERITA BALLIU**, përfaqësuar me prokurë nga avokate Tabena Jahaj.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-4403 (525), datë 20.09.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi S.J. dhe shoqëria Kristi Co sh.p.k. (*shoqëria*) kanë lidhur kontratën e sipërmarrjes nr.1612 rep., nr. 237/2 kol., datë 13.03.2007, për një apartament me sipërfaqe 107.3 m², të ndodhur në godinën 10-katëshe në Astir, në zonën e Unazës së Re. Me kontratën nr. 5708 rep., nr. 843/1 kol., datë 30.07.2007, shoqëria i ka shitur apartamentin shtetasit S.J. Godina është ndërtuar nga shoqëria bazuar në vendimin nr. 21, datë 18.11.2006 të Këshillit të Rregullimit të Territorit, komuna Kashar. Gjithashtu, ka rezultuar se edhe kërkuesja Merita Balliu ka lidhur me shoqërinë kontratën e sipërmarrjes së datës 08.11.2010 për një apartament me sipërfaqe 114.5 m², të ndodhur në katin e gjashtë dhe një dyqan me sipërfaqe 40 m² të ndodhur në të njëjtën godinë.

2. Nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllim të shqyrtimit të çështjes, ka rezultuar se administratori i shoqërisë Kristi Co sh.p.k., nëpërmjet një deklarate noteriale të datës 13.04.2012, është shprehur se: *“Shtetasi S.J. ka shlyer totalisht shumën e apartamentit prej 45.066 euro në datën 30.09.2007. Ky apartament nga nëntori 2011 është zaptuar nga Merita Balliu, e cila nuk ka kontratë për këtë apartament, por megjithëse është njoftuar për ta liruar nuk e ka liruar apartamentin.”*. Po sipas kësaj deklarate, rezulton se administratori i shoqërisë ka marrë përsipër detyrimin që brenda datës 25.05.2012 apartamenti t'i kthehet shtetasit S.J. dhe nëse nuk arrihet brenda kësaj date, ai do të kompensohet me një apartament tjetër në të njëjtin bllok banimi.

3. Gjithashtu, ka rezultuar se nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 24.09.2012 administratori i shoqërisë dhe kërkuesja kanë deklaruar se ajo ka porositur pranë shoqërisë një apartament në katin e gjashtë, me sipërfaqe ndërtimore 114, 50 m², një dyqan dhe një garazh, si dhe ka ekzekutuar të gjitha pagesat e çmimit. Kërkuesja ka deklaruar se ajo banon në apartament prej një viti e gjysmë, ka bërë punime shtesë dhe nuk ka vullnet për ta ndërruar me një tjetër.

4. Shtetasi S.J., me pretendimin se apartamenti i tij posedohej në mënyrë të paligjshme nga kërkuesja, në datën 25.05.2012 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi, duke kërkuar detyrimin e kërkueses për lirim dhe dorëzimin e apartamentit me sipërfaqe 107.3 m², të ndodhur në godinën 10-katëshe në Astir, në zonën e Unazës së Re. Në përfundim të gjykimit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5217, datë 25.04.2014, ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e kërkueses t'i lirojë dhe dorëzojë shtetasit S.J. apartamentin me sipërfaqe 107.3 m², të ndodhur në Tiranë.

5. Mbi ankimin e kërkueses, Gjykata e Apelit Tiranë ka shqyrtuar çështjen dhe me vendimin nr. 1596, datë 25.06.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 5217, datë 25.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e padisë. Sipas gjykatës së apelit, gjykata e shkallës së parë nuk ka çmuar siç duhet provat e paraqitura nga palët në proces dhe nuk ka interpretuar ligjërisht veprimet juridike. Gjykata e apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka gabuar në zgjidhjen e konfliktit midis palëve ndërgjyqëse dhe se paditësi S. J. duhet t'i drejtohet rrugës gjyqësore ndaj personit të tretë/shoqërisë së ndërtimit vetëm nëse nuk zbatohet marrëveshja e lidhur mes tyre e datës 13.04.2012.

6. Ndaj vendimit të gjykatës së apelit kanë ushtruar rekurs shtetasi S.J. dhe kundërrekurs kërkuësja. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4403 (525), datë 20.09.2023, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1596, datë 25.06.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 5217, datë 25.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7. Kërkuësja në datën 02.04.2024 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

II

Pretendimet e kërkueses

8. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se është cenuar:

8.1. *Gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi rekursi duhej të shqyrtohej sipas dispozitave që kanë qenë në fuqi në vitin 2015 kur është paraqitur rekursi, duke cenuar edhe parimin e veprimit të ligjit në kohë. Dispozitat e reja ligjore e kanë kufizuar paraqitjen dhe shqyrtimin e rekursit, duke cenuar të drejtën e aksesit për të shqyrtuar të gjitha shkaqet e ngritura në rekurs. Gjykata e Lartë ka anashkaluar pretendimet e ngritura në kundërrekurs.

8.2. *E drejta për t'u mbrojtur dhe parimi i kontradiktoritetit*, pasi kërkueses nuk i është dhënë mundësia për t'u mbrojtur dhe për të paraqitur argumente, për sa kohë që provat e paraqitura jo vetëm nuk janë marrë në konsideratë nga pikëpamja formale, por as nuk janë pasqyruar e shqyrtuar, qoftë edhe formalisht, në vendimin e Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye, kërkuësja është vendosur në pozitë të pafavorshme kundrejt palës tjetër.

8.3. *Parimi i sigurisë juridike, pritshmëritë e ligjshme dhe e drejta e pronësisë*, pasi Gjykata e Lartë ka detyruar kërkuesen të dorëzojë pronën në favor të shtetasit

S.J., pa shfuqizuar më parë titullin e pronësisë së saj. Kërkuesja e ka fituar pronësinë me ligjet nr. 9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” (ligji nr. 9482/2006) dhe nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 20/2020), si dhe me vendimet e nxjerra në zbatim të tyre, që janë mënyra origjinale dhe të barabarta më mënyrat e tjera të fitimit të pronësisë. Lidhur me këtë fakt, në datën 12.09.2023, përpara seancës gjyqësore është paraqitur në Gjykatën e Lartë shkresa nr. 4477 prot., datë 12.09.2023, duke depozituar prova shtesë të dala pas vendimit të gjykatës së apelit për legalizimin e apartamentit. Gjykata padrejtësisht ka detyruar kërkuesen për të dorëzuar sendin, pa njohur minimumin e vlerës së shpenzimeve të bëra prej saj në apartament, të cilat janë pranuar edhe nga vetë shoqëria e ndërtimit. Gjykatat kanë abuzuar duke i njohur shtetasit S.J. të drejtën e pronësisë, në kushtet kur ai nuk e ka fituar atë.

8.4. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar me hollësi dhe argumentuar se përse nuk janë marrë parasysh pretendimet e ngritura në kundërrekurs. Gjykata e Lartë nuk i ka përmendur, qoftë edhe formalisht, provat e reja dhe nuk ka arsyetuar se përse gjatë gjykimit në gjykatën e apelit ka shkelje të ligjit material ose të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës,

sepse është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

11. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke kundërshtuar vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

12. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-mujaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Konstatohet se vendimi më i fundit në kohë (vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë) i kundërshtuar nga kërkuesja mban datën 20.09.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 02.04.2024. Për sa i përket përmbushjes së këtij kriteri, kërkuesja ka pretenduar se me vendimin është njohur në datën 30.11.2023, pasi sipas shkresës nr. 1006/1 prot., datë 27.02.2024, Gjykata e Lartë është shprehur se vendimi i arsyetuar është dorëzuar në datën 30.11.2023.

13. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se si datë e fillimit të afatit ligjor 4-mujor për paraqitjen e tij, në rastin e procesit gjyqësor, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor. Kur objekt i ankimit kushtetues individual është një vendim i Gjykatës së Lartë, si datë e marrjes dijeni për vendimin gjyqësor është ajo kur vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare të saj ose përmes njoftimit elektronik të tij, kur palët kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 40, datë 14.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se kërkuesja prej datës 30.11.2023 ka pasur mundësi të njëjeh efektivisht me vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 02.04.2024. Në rastin konkret, rezulton se afati ligjor 4-mujor ka përfunduar në datën 30.03.2024, e cila ka qenë ditë e shtunë, ndërsa datat vijuese 31.03.2024 ka qenë ditë e diel dhe 01.04.2024 kanë qenë ditë pushimi zyrtar. Sipas nenit 15, pika 3, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, kur afati mbaron në ditë pushimi ose feste, ai shtyhet deri në ditën pasardhëse të punës ose jofestive. Në vijim, referuar standardeve në lidhje me

momentin e marrjes dijani të vendimit të fundit objekt kundërshtimi, Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkesja ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë është rezultat i procesit jo të rregullt ligjor, ndaj i ka cenuar: (i) gjykimin nga një gjykatë e caktuar me ligj; (ii) të drejtën për t'u mbrojtur dhe parimin e kontradiktoritetit; (iii) parimin e sigurisë juridike, pritshmërive të ligjshme dhe të drejtën e pronësisë; (iv) standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

16. Kolegji vëren se për parimin e sigurisë juridike, pritshmërive të ligjshme dhe të drejtën e pronësisë, kërkesja pretendimet e saj i ka ngritur ndaj procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, ndaj ato do të analizohet në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat kushtetuese nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Në vijim, duke mbajtur në konsideratë argumentet të parashtruara nga kërkesja, Kolegji do të analizojë pretendimet në këndvështrim të gjykatës së caktuar me ligj, së drejtës për t'u mbrojtur dhe parimit të kontradiktoritetit, si dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike dhe të drejtën e pronësisë.

B. Për pretendimin e cenimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj

17. Kërkesja ka pretenduar se rekursi duhej të shqyrtohej sipas dispozitave që kanë qenë në fuqi në vitin 2015 kur është paraqitur ai, duke cenuar edhe parimin e veprimit të ligjit në kohë. Dispozitat e reja ligjore e kanë kufizuar paraqitjen dhe shqyrtimin e rekursit duke cenuar të drejtën e aksesit për të shqyrtuar të gjitha shkaqet e ngritura në rekurs.

18. Gjykata ka pohuar se shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*” është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Termi “*gjykatë*” karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar për një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 23, datë 23.07.2009; nr. 7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Civile me ligjet nr. 38/2017 dhe nr. 44/2021, në dhomën e këshillimit verifikohej vetëm legjitimiteti i kërkesit, bazueshmëria në ligj e rekursit, si dhe prania e kritereve ligjore për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ndërsa gjatë gjykimit të çështjes në seancë gjyqësore shqyrtohej bazueshmëria e

vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, pra themeli i çështjes. Ndërkohë që me hyrjen në fuqi të ndryshimeve ligjore të lartpërmendura, kompetencat e dhomës së këshillimit kanë pësuar rregullime të reja, pasi në të mund të shqyrtohet tashmë edhe themeli i shkaqeve të ngritura në rekurs (nenet 482, 482/a dhe 485 të KPC-së të ndryshuar me ligjin nr. 44/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë””, të ndryshuar (*ligji nr. 44/2021*).

20. Në këtë pikëpamje, për të vlerësuar respektimin e gjykatës së caktuar me ligj në drejtim të procedurës dhe kompetencave, në rastin e kolegjeve të Gjykatës së Lartë është e rëndësishme të evidentohet se shqyrtimi i rekursit ndjek dy faza procedurale të ndryshme, në të cilat kompetencat e kolegjeve janë të ndryshme: (i) faza e shqyrtimit paraprak, procedurë e cila zhvillohet gjithnjë në dhomën e këshillimit dhe kompetencat e Kolegjit të Gjykatës së Lartë ushtrohen *de plano*, pasi lidhen me seleksionimin e rekurseve të suksesshme; (ii) faza e shqyrtimit të themelit të shkaqeve të rekursit, procedurë e cila sipas natyrës së çështjes dhe në diskrecion të Kolegjit të Gjykatës së Lartë mund të zhvillohet në dhomën e këshillimit ose në seancë me pjesëmarrjen e palëve, ku kompetencat e Kolegjit të Gjykatës së Lartë lidhen me themelin e shkaqeve të rekursit rreth çështjeve të kuptimit të ligjit, sipas hipotezave të detajuara në ligjet procedurale.

21. Në rastin konkret, Kolegji vëren se rekursi është paraqitur në datën 20.07.2015 nga pala paditëse në gjykim dhe se kërkuesja/e paditur në datën 01.09.2015 ka paraqitur kundërrekurs. Çështja është shqyrtuar në themel nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit në datën 20.09.2023, sipas rregullave të reja procedurale. Konkretisht, në nenin 32 (dispozitat kalimtare) të ligjit nr. 44/2021 parashikohet se përbërja e trupit gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera dhe rekurset e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre. Këtë fakt e ka cituar edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i cili është shprehur se në rastin e rekurseve të cilat janë depozituar dhe regjistruar përpara datës së hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve, në funksion edhe të garantimit të të drejtave të palëve ndërgjyqëse, për efektet e pranueshmërisë së rekursit, mbahet parasysh ligji i kohës së regjistrimit të tyre (*shih paragrafin 14 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në përfundim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë bazuar në nenin 485, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit. Në këtë drejtim, Gjykata, në mënyrë të vazhdueshme, ka theksuar se përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe, ligji procedural zbatohet menjëherë në përputhje me

parimin *tempus regit processum*. Në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe (*shih vendimet nr. 3, datë 11.02.2021; nr. 1, datë 26.01.2021; nr. 11, datë 23.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar rekursin në respektim të rregullave procedurale dhe pretendimi për cenimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u mbrojtur dhe parimit të kontradiktoritetit

23. Kërkesja ka pretenduar se nuk i është dhënë mundësia për t'u mbrojtur dhe për të paraqitur argumente, për sa kohë që provat e paraqitura në Gjykatën e Lartë jo vetëm nuk janë marrë në konsideratë nga pikëpamja formale, por as nuk janë pasqyruar e shqyrtuar, qoftë edhe formalisht, në vendimin e Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye, kërkesja është vendosur në pozitë të pafavorshme kundrejt palës tjetër.

24. Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit, t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte parimi i barazisë së armëve, atëherë argumentet e njëjës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 22, datë 22.09.2022; nr. 8, datë 23.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Referuar dispozitave procedurale për njoftimin e ankimit në fuqi në kohën e paraqitjes së rekursit, vërehet se sipas nenit 476 të KPC-së, rekursi depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin, në afatin prej 30 ditësh nga njoftimi që u është bërë palëve, duke përcaktuar edhe dokumentet shoqëruese. Neni 477 i KPC-së parashikon se pala kundër

së cilës është paraqitur rekursi mund ta kundërshtojë atë me kundërrekurs, i cili duhet t'i njoftohet atij që ka bërë rekursin në vendbanimin e tij brenda 20 ditëve nga njoftimi i rekursit.

26. Në rastin konkret, rezulton se pas paraqitjes së rekursit nga shtetasi S.J./pala paditëse, kërkuesja ka paraqitur kundërrekurs, në të cilin ka parashtruar argumentet e saj.

27. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kërkuesja i ka pasur dhe i ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë e njohura nga ligji për të mbrojtur të drejtat e saj nëpërmjet paraqitjes së kundërrekursit dhe nuk rezulton të jetë vendosur në pozita të disfavorshme me palën tjetër. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i saj për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur dhe parimit të kontradiktoritetit është haptazi i pabazuar.

Ç. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike dhe të drejtën e pronësisë

28. Kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka detyruar kërkuesen të dorëzojë pronën në favor të shtetasit S.J., pa shfuqizuar më parë titullin e saj të pronësisë. Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar me hollësi dhe argumentuar se përse nuk janë marrë parasysh pretendimet e ngritura në kundërrekurs. Kërkuesja e ka fituar pronësinë me ligjet nr. 9482/2006 dhe nr. 20/2020. Lidhur me këtë fakt, në datën 12.09.2023 përpara seancës gjyqësore është paraqitur në Gjykatën e Lartë shkresa nr. 4477 prot., datë 12.09.2023, duke depozituar prova shtesë të dala pas vendimit të gjykatës së apelit për legalizimin e apartamentit. Gjykata e Lartë nuk i ka përmendur, qoftë edhe formalisht, provat e reja dhe nuk ka arsyetuar se përse gjatë gjykimit në gjykatën e apelit ka shkelje të ligjit material ose praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë.

29. Sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 9, datë 23.02.2023; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata ka theksuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit

gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se procesi gjyqësor ka nisur për padinë e shtetasit S.J., pasi pretendonte se apartamenti i tij posedohej në mënyrë të paligjshme nga kërkuesja. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5217, datë 25.04.2014, ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e kërkueses t'i liroje dhe dorëzojë shtetasit S.J. apartamentin me sipërfaqe 107.3 m², të ndodhur në Tiranë. Gjykata e rrethit, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se S.J. ka vërtetuar se është pronar i apartamentit me sipërfaqe 107.3 m² dhe se e ka fituar pronësinë bazuar në nenin 164 të Kodit Civil (KC). Pretendimet e palës së paditur/kërkueses se ka lidhur një kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë e ndërtimit dhe për rrjedhim ka fituar posedimin në mënyrë të ligjshme është i pabazuar në ligj e në prova, pasi nuk mund të shërbente për kalimin e pronësisë, jo vetëm për faktin se firma ndërtuese e ka humbur pronësinë për këtë apartament me kontratën nr. 5708 rep., nr. 843/1 kol., datë 30.07.2007 dhe, për pasojë, nuk mund të transferonte të drejta që nuk i disponon, duke bërë në këtë mënyrë që këto veprime të jenë të pavlefshme, por ajo nuk gëzonte dhe formën e caktuar nga ligji për të transferuar pronësisë. Gjykata e rrethit ka vijuar në arsyetim se kërkuesja/pala e paditur ka në kontratë një apartament ndryshe me atë që është në kontratën e paditësit me drejtim dhe kufizime të ndryshme, fakt që ka rezultuar edhe nga akti i ekspertimit (*shih faqen 6 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*).

32. Mbi ankimin e kërkueses, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1596, datë 25.06.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 5217, datë 25.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e padisë, si të pabazuar në ligj dhe prova. Gjykata e apelit ka arsyetuar se gjykata e rrethit nuk ka çmuar siç duhet provat e paraqitura nga palët në proces, si dhe nuk ka interpretuar drejt veprimet juridike. Gjykata e apelit ka vijuar se konflikti është rrjedhojë e gabimit të bërë nga ndërtuesi i objektit, pasi me palën paditëse ka nënshkruar një deklaratë të re noteriale ku ka marrë përsipër të kalojë pronësinë e një apartamenti tjetër në të njëjtin bllok ndërtimesh me sipërfaqe 120 m² dhe për këtë ka qenë dakord edhe pala paditëse në proces. Pala paditëse/S.J. ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë e ndërtimit/personin e tretë në gjykim, por, bazuar në nenin 858 të KC-së ka qenë vullneti i palës së paditur/kërkueses për shfaqjen e një vullneti të ri për sa i përket apartamentit, meqenëse e posedonte në mënyrë të ligjshme dhe në mirëbesim atë. Sipas Gjykatës së apelit, gjykata e

shkallës së parë ka gabuar në zgjidhjen e konfliktit midis palëve ndërgjyqëse në proces dhe se paditësi duhej t'i drejtohej rrugës gjyqësore ndaj personit të tretë vetëm në qoftë se nuk zbatohet marrëveshja e dytë midis tyre (*shih faqet 7, 8 dhe 9 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

33. Ndaj vendimit të gjykatës së apelit kanë ushtruar rekurs shtetasi S.J. dhe kundërrekurs kërkuesja. Kolegji Civil ka arsyetuar se gjykata e apelit nuk ka identifikuar drejt objektin e shkakun ligjor të padisë dhe në interpretim të gabuar të ligjit material ka cenuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, i cili është dhënë në përputhje me nenet 296 e vijues dhe 850 e vijues të KC-së. Sipas Kolegjit Civil, duke krahasuar dy vendimet e gjykatave të faktit, rezulton se ajo ndodhej përpara dy vendimeve të kundërta. Përderisa dy vendimet e gjykatave të faktit janë kontradiktore lidhur me vërtetimin e kushtit të fitimit të së drejtës së pronësisë dhe posedimit të paligjshëm të së paditurës për pasurinë objekt gjykimi, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka juridiksion rishikues ligjor për të përcaktuar se cila nga gjykatat e shkallëve më të ulëta ka cilësuar më drejtë mosmarrëveshjen sipas “faktit të pranuar prej tyre” dhe ka interpretuar më drejtë nenet 11 e 16 të KPC-së. Në analizë të pjesës arsyetuese të vendimit të gjykatës së rrethit dhe të asaj të apelit, Kolegji Civil ka çmuar se në përputhje me kërkesat e nenit 126 të KPC-së, vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe ka identifikuar saktë shkakun ligjor në ngritjen e padisë sipas pretendimeve, prapësimeve të palëve e provave të paraqitura në gjykim, ndërsa gjykata e apelit ka bërë një interpretim të gabuar të kushteve ligjore të kontratës së sipërmarrjes në kundërshtim me qëllimin ligjor për të cilën palët kanë hyrë në këtë marrëdhënie. Referuar fakteve të pranuar nga të dyja gjykatat, del se apartamenti është realizuar fizikisht dhe paditësi ka shlyer të gjithë çmimin e tij, ndërkohë që ai posedohet nga pala e paditur. Duke mbajtur në konsideratë se apartamenti është realizuar në bazë të një lejeje ndërtimi dhe për llogari të paditësit si pala blerëse me kontratën noteriale nr. 5708 rep., nr. 843/1 kol., datë 30.07.2007, del se paditësi ka vërtetuar të drejtën e pronësisë për apartamentin në kuptim të neneve 149, 164 e vijues të KC-së. Për aq kohë sa kontratat e sipërmarrjes ose të porosisë në fushën e ndërtimit të lidhura drejtpërdrejt me ndërtuesin përbëjnë akte të vlefshme për fitimin e pronësisë në emër të porositësve, atëherë paditësi konsiderohet si pronar i apartamentit, pavarësisht se sendi apartament ende nuk është regjistruar si një objekt më vete (*shih faqet 11 dhe 12 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në përfundim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4403 (525), datë 20.09.2023, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1596, datë 25.06.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 5217, datë 25.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

34. Kolegji konstaton se kërkesja, bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, ka depozituar edhe shkresën “Shpjegime për kundërrekursin dhe depozitim të provave të reja”, të protokolluar me vulën e Gjykatës së Lartë nr. 4477 prot., datë 12.09.2023, sipas së cilës është shprehur se u qëndron shpjegimeve të parashtruara në kundërrekurs dhe ka kërkuar të depozitohet në dosjen gjyqësore disa prova të reja të krijuara pas gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit që lidheshin me vendimin për legalizimin e ndërtimit pa leje.

35. Lidhur me paraqitjen e shkresës nr. 4477 prot., në datën 12.09.2023, vetëm 8 ditë përpara zhvillimit të seancës në Gjykatën e Lartë, sipas së cilës kërkesja ka kërkuar të depozitohet prova të reja, Kolegji konstaton se ajo ka dërguar një shkresë, por nuk duket se e ka shoqëruar me prova/dokumente, ndërkohë që edhe nga përmbajtja e dosjes gjyqësore nuk rezulton të ndodhet kjo shkresë. Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson se edhe pse Gjykata e Lartë nuk e ka evidentuar, qoftë edhe formalisht, paraqitjen e saj, ky fakt nuk cenon thelbin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Gjykata ka theksuar se detyrimi për të garantuar këtë standard nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë ka analizuar dhe vlerësuar vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta në raport me shkaqet e paraqitura në rekurs, faktet e çështjes dhe ligjin e zbatueshëm, në përmbushje të funksionit të saj për të kontrolluar vendimmarrjen e atyre gjykatave. Në vështrim të standardeve kushtetuese të arsyetimit, mospasqyrimi i shkresës “Shpjegime për kundërrekursin dhe depozitim të provave të reja” nuk i cenon këto standarde, për sa kohë që Gjykata e Lartë brenda funksionit të saj rishikues ka dhënë përgjigje për interpretimin e ligjit të zbatueshëm në rastin konkret. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se edhe pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike dhe të drejtën e pronësisë është haptazi i pabazuar.

37. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.